



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË  
BORDI

VENDIM

Nr. 255, Datë 23.08.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K.  
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGISJË ELEKTRIKE NGA CENTRALI  
FOTOVOLTAIK “TEKSOEN 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/1 prot., datë 18.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.08.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s një pagesë më të vogël se ajo e parashikuar në Aneksin A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, dhe në vijim do të njoftohet subjekti që të kryejë pjesën e mbetur të pagesës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 2.1**

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të plotësojë shtojcën 2 me informacion mbi llojin e paneleve, nëse janë on shore apo off shore.
- Aplikuesi duhet të bëjë saktësimet përkatëse për jetëgjatësinë e pritshme të centralit, nga do të varet dhe afati i vlefshmërisë së licencës.
- Duke qenë se shoqëria ka parashikuar të fillojë punimet në vitin 2023, por në kuadër të vlefshmërisë dhe VNM-së Paraprake të depozituar në ERE, vlerësohet t’i kërkohej informacion nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**